

Kontrate Dhurimi Kuotash
Sot, me 08.03.2021,
midis paleve;

Armando Sadiku i biri i Vladimir dhe Vejulka, rezident ne Tirane, shtetas shqiptar, lindur me 23.12.1985 ne Shkoder, identifikuar me passaporte nr. BB6354349, madhor e me pergjegjesi te plote per te vepruar

Ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise me pergjegjesi te kufizuara "Benet Holding" shpk, e regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit, me nr. Nuis: L81508016Q me seli Lunder, Farke, Tirane, Zona Kadastrale 2529 dhe numer pasurie 558/34 Tirane.
DHE

Genta Perleka e bija e Telman dhe Meliha, rezident ne Tirane, Rruga e Durrës, shtetase shqiptare, lindur ne Peshkopi, Diber, me 17.04.1987, identifikuar me karte identiteti nr. I75417005B, madhore e pergjegjesi te plote per te vepruar;

Kushtet paraprake

Pas vendimit te ortakeve nr. 1, dt. 08.03.2021, palet vendosin te konkludojne kete kontrate Dhurimi Kuotash sipas kushteve ne vijim:

Neni 1

Dhurimi i Kuotave

Nepermjet kesaj kontrate:

Armando Sadiku zoteruese e nje kuote te barabarte me 100% te kapitalit te shoqerise me vlere nominale 10.000,00 leke, transferon:

Genta Perleka, nje kuote te barabarte me 100% te kapitalit te shoqerise, me vlere nominale 10.000,00 leke.

Pas dhurimit te kuotes, kapitali i shoqerise ndahet si vijon:

Genta Perleka zoteron nje kuote ekuivalente me 100% te kapitalit te shoqerise te barabarte me 10.000,00 leke.

Neni 2

Deklarime dhe garanci te paleve

2.1. Deklarime dhe garanci te Dhuruesit

Duke konsideruar kete kontrate dhurimi kuotash dhe kushtet e Shoqerise, Dhuruesi dhe pranuesi i dhurimit ne daten e nenshkrimit te kesaj kontrate, japin deklarimet dhe garancite si vijon (me poshte "Deklarimet dhe Garancite e Dhuruesit"):

- Shoqeria eshte themeluar dhe operon rregullisht ne baze te ligjit dhe te drejtes tregtare shqiptare si dhe ne baze te gjithë legjislacionit dhe akteve te shoqerise, ka te drejta te plota per te vepruar mbi pronesine e shoqerise konform dhe statutit te shoqerise.
- Shoqeria nuk ka debi apo kredi te cfaredolloj tipi, qe nuk jane te perfshira ne regjistrat kontabel te shoqerise deri ne afatin e nenshkrimit te kesaj kontrate.
- Shoqeria nuk gezon pronesi te paluajtshme.



- Shoqeria nuk eshte pjese e asnje ceshtje konfliktuale aktuale apo te kaluar apo pale e lidhur ne ndonje konflikt ligjor, qofte edhe e denoncuar ne gjykate kombetare apo nderkombetare apo organ administrativ apo kolegji arbitrazhi edhe nepermjet kontrolleve dhe procedimeve qe kane per objekt pergjegjesine administrative.
- Shoqeria nuk ka dhunuar asnje normative ligjore dhe ka vepruar ne respekt te normativave te aplikueshme per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise.
- Persa ne dijeni te Dhuruesit, nuk konsiderohet false apo e pasakte asnje deklarim apo e drejte garancie e dhene ne kete kontrate.

2.2. Deklarime dhe Garanci te Pranuesit te Dhurimit

Per sa lidhur ne kete kontrate dhurimi kuotash ne menyre solide, Pranuesi i Dhurimit jep deklaratat dhe garancite si vijon: (Ne vijim, deklarimet dhe Garancite e Pranuesit te Dhurimit):

- Pranuesi i Dhurimit deklaron se eshte informuar dhe ka dijeni mbi dokumentacionin fiskal dhe kontabel te shoqerise si dhe mbi te gjitha kartelat e detajuara pjese perberese e bilancit deri me sot.
- Pranuesi i Dhurimit deklaron se ka dijeni te plote mbi situaten e shoqerise edhe ne marredhenie me bankat, pagat, entet shtetore, furnitoret dhe kreditoret dhe pranon situaten aktuale si paraqitet deri me sot.

Neni 3

Shpenzime dhe Taksa

Shpenzimet ligjore dhe kontabile, taksat dhe te tjera te lidhura me kete kontrate, jane ne ngarkim te pranuesit te dhurimit te kuotave.

Neni 4

Klauzola kalimtare dhe zgjidhja e kontrates dhe mosmarreveshjeve

Per te gjitha mosmarreveshjet qe rrjedhin nga zbatueshmeria e kesaj kontrate pas nenshkrimit te saj, perfshire ato te lidhura me vlefshmerine e saj, interpretimit dhe zbatimin e rregullores; palet do te kerkojne zgjidhje prane Gjykates se Tiranes, Shqiperi.


Neni 5

Ndryshimi i Kontrates

Kjo kontrate perfshin raportin midis paleve dhe krijon marredhenien midis te gjithe aktoreve te lidhur ne kete kontrate persa i perket objektit te saj. Ndryshimet apo shtesa ne kete kontrate do te quhen te vlefshme vetem ne forme te shkruar dhe nenshkruar midis paleve.

Kjo kontrate u hartua ne 3 kopje me te njejten vlere ligjore dhe perbehet nga 2 flete.


GENTA PERLEKA
PRANUESI I DHURIMIT


ARMANDO SADIKU
DHURUESI

